



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 54/12

Prishtinë, më 23.03.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Latif Gashi Hasime Krasniqi Hykmete, Bajrami Sali Asllanaj, Muhamet Mustafa dhe Duda Balje.

Munguan: Naser Osmani, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Ardita Fejza (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Ramadan Islami, Njomza Ilazi nga GIZ, monitorues nga KDI, OSCE.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit më Amendamente për projektligjin nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit më Amendamente për projektligjin nr. 04/L-98 për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet njëzëri.

2. Shqyrtimi i Raportit më Amendamente për projektligjin nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë

Kryetarja, njoftoi se të gjitha amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa janë marrë parasysh nga komisioni funksional dhe janë përfshirë në këtë raport, me përjashtim të amendamentit përmes së cilit

kemi kërkuar që përqindja e financimit të RTK-së të jetë 0.7% që është në pajtim me ligjin e buxhetit. Komisioni funksional ka propozuar që përqindja e financimit të jetë 0.8% e të hyrave të buxhetit të Kosovës. Lidhur me këtë çështje ne duhet të diskutojmë dhe të deklarojemi se a qëndrojmë prapa rekomandimit për financimin e RTK-së prej 0.7%. Siq e dini e kemi edhe një kërkesë të RTK-së për ndarje të mjeteve për një auditim të performancë dhe komisioni e ka shtyer shqyrtimin dhe nxjerrjen e rekomandimit për këtë kërkesë deri në miratimin e Ligjit për Transmetuesin Publik. Çështja tjetër që nuk ka qenë e përfshirë në raportin e parë të komisionit funksional është edhe amendamenti i propozuar nga GP 6+ sipas së cilit kërkohet të plotësohet paragrafi 6 i nenit 8 që thotë në përputhje me kushtet dhe mundësitë financiare hapësinore logjistike teknike RTK ja munde të zgjeroj rrjetin e ti transmetuese edhe në kanalet e komuniteteve tjera. Ky amendamenti nuk është përkrah nga komisioni funksional.

Sali Asllanaj, theksoi se propozimi për financim prej 0.7% ka qenë zgjidhja më e mirë, pasi që është edhe në pajtim me Ligjin e buxhetit që objektivist e i parasheh keto shifra, dhe miratimi shifrave tjera apo në koeficient tjetër, do të thoshte se po biem në kundërshtim me ligjin e buxhetit dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.

Latif Gashi, theksoi se ne duhet të pajtohemi me propozimin e komisionit, dhe duke i marr parasysh disa ndryshime tjera që janë bërë në projektligj, siq është rasti i kanaleve të reja dhe zvogëlimit të reklamave, mendoj se është e drejtë që financimi të jetë 0.8%. Sa i përket amendamentit të grupit parlamentar 6+ është një kërkesë e drejtë, pasi që është fjala për një periudhë kohore të gjatë. Për derisa lejojmë një kanal në gjuhën serbe, pse mos të lejojmë kanale edhe në gjuhën e komunitete tjera. Ashtu edhe nuk prodhon efekte të drejtpërdrejta buxhetore, sepse thuhet varësisht nga mundësitë buxhetore, RTK-ja mund të krijojë kanale në gjuhët tjera.

Sali Asllanaj, theksoi e hapja e kanaleve tjera ndikon direkt në koston buxhetore. Është zgjidhje tjetër hapja e një kanali në gjuhën serbe, pasi që del nga Pakoja e Ahtisarit. Nuk duhet bazohemi në dëshira, por në mundësitë reale buxhetore që kemi.

Latifi Gashi, pasi që edhe komunitetet tjera janë taksapagues në buxhetin e Kosovës që nënkupton se marrin pjesë edhe në pagesën për financimin e RTK-së. Edhe ata janë qytetar të Kosovës dhe duhet ti gëzojnë të gjitha të drejtat si gjithë komunitetet tjera. Është një kërkesë e drejtë dhe duhet të lihet me ligj që edhe komunitetet tjera të kenë mundësinë të hapin kanale në gjuhët e tyre, duke pasur parasysh mundësitë buxhetore.

Duda Balje, amendamenti i propozuar nga grupi parlamentar 6+ është në harmoni me ligjin. Amendamenti thotë se kur të krijohen kushtet financiare dhe teknike, komunitetet tjera mund të hapin kanale tjera. Tani nuk do të ketë efekte të drejtpërdrejta buxhetore dhe qëllimi është të krijohet baza ligjore që lejon një mundësi të këtillë. Pasi që obligimi për krijimin e kanalit serb del nga Pakoja e Ahtisarit, pse mos të lejohet mundësia që të hapen edhe kanale tjera. Edhe komunitetet tjera janë taksapagues për buxhetin e Kosovës dhe financimin e RTK-së.

Kryetarja, rikujtoj se objekt shqyrtimi i amendamenteve në Komisioni për Buxhet dhe Financa është vlerësimi i koston buxhetore të amendamenteve dhe jo të bazohemi në anën morale.

Latifi Gashi, ritheksoi se nëse lexojmë amendamentin 8 paragrafin 6 të komisionit funksional, shifet se nuk do të ketë implikime direkte buxhetore për RTK, pasi që thuhet se mund të zgjerohet rrjeti i transmetimit edhe në kanalet tjera, duke për përfshirë kanalet në komunitetet tjera.

Muhamet Mustafa, theksoi se nëse mbetet 0.8%, do të duhej që në dispozitat kalimtare të thuhet se që kjo normë hynë në fuqi në buxhetin e ardhshëm, pasi që është aprovuar buxheti, apo kjo zgjidhje mund të bëhet nëse kemi rebalancim të buxhetit. Sa i përket keti amendamenti të propozuar nga Grupi parlamentar 6+, edhe unë pajtohem se duhet të kalojë dhe ka një arsyeshmëri jo vetëm politike por edhe përmbajtësore dhe angazhimi i tyre si qytetar të Kosovës. Duhet të kemi konsideratë për punën dhe integritimin e tyre në shoqërinë kosovare dhe duhet ti përgjigjemi me një qëndrim pozitiv. Ndoshta do të duhej të rregullohet që të kemi një kanal, që transmeton programe në shumë gjuhë.

Xhevdet Neziraj, theksoi se mbështet ato qfarë u thanë nga profesori për çështjen e përqindjes. Unë mendojë që duhet të jemi unik dhe ndoshta do të ishte mirë të ulemi dhe të bisedojmë me komisionin funksional për këto çështje. Sa i përket kanaleve televizive, nëse diskutojmë për politika diskriminuese të RTK-së do të kisha thënë se komuniteti egjiptas është më i diskriminuar, jo gjuhësisht pasi që gjuha jonë amtare është shqipja, mirëpo qasja ndaj deputetëve dhe problemeve të komunitetit egjiptas më së paku trajtohen në RTK. Komunitetet tjera në kuadër të kanalit të RTK-së e kanë minutazhen e vet. Kjo nuk ndodh me komunitetin egjiptas, ku nuk ofrohet hapësira e mjaftueshme për promovimin e jetës dhe aktiviteteve të këtij komuniteti. Me gjithat ne duhet të ndalemi në aspektin financiar dhe nuk duhet mbyllur sytë, pasi që nëse kalon ligji me këto ndryshime, do të duhet punësimi ndoshta i 50 punëtorëve dhe kjo sjell implikime të mëdha buxhetore që do të kemi problemet e njëjta edhe vitin tjetër me buxhetin e RTK-së.

Hykmete Bajrami, me që në ligjin e buxhetit për vitin 2012, është përcaktuar shifra 0.7% për financimin e RTK-së, dhe nëse vendoset që të jetë 0.8% do të duhej thënë se kjo hynë në fuqi prej vitit të ardhshëm, sepse përndryshe do të binim në kundërshtim me ligjin e buxhetit.

Duda Balje, theksoi se nuk do të duhej përzier çështja e kanalit në gjuhën serbe me atë që po kërkohet për krijimin e bazës ligjore për mundësinë e hapjes së kanaleve tjera dhe kur të krijohen mundësitë financiare, të mund të hapen kanale edhe në gjuhët tjera. Kjo duhet të mundësohet me ligj.

Kryetarja, për ne si komision për buxhet dhe financa, rritja prej 0.7% në 0.8 %, do të thotë implikime buxhetore shtesë dhe ne nuk mund të bien në kundërshtim me ligjin e buxhetit që e kemi aprovuar. Madje një përqindje prej 0.7% është planifikuar në KASH. Mendojë që duhet të shkojmë me propozimin tonë 0.7% dhe në rast se Kuvendi e miraton propozimin e komisionit funksional do të duhej të bëhet ndryshimi i ligjit të buxheti, apo diferenca të mbulohet me rishikim të buxhetit, si dhe kjo shifër të ndryshohet edhe me KASH-in 2013-2015. Amendamenti i propozuar nga 6+ siq është propozuar nuk prodhon efekte buxhetore shtesë direkte dhe mendojë që për periudhën e financimit të RTK-së nga buxheti nuk mund të bëhet. Por ne mund të konstatojmë se nuk prodhon kosto buxhetore dhe mëpastaj nëse kalon në Kuvend, çështja e krijimit të kanaleve tjera mund të diskutohet kur të gjindet mënyra e financimit të RTK-së.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 04/L-46 për transmetimin publik në Kosovë, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, për Projektligjin nr. 04/L-46 për

Transmetuesin Publik në Kosovë, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të Amendamentit 9.

3. Komisioni propozon që në amendamentin 9 të komisionit funksional që i referohet ndryshimeve në nenin 23 që bëhet neni 22, në paragrafin 4, të bëhen ndryshimet si në vijim:

Amendamenti 1

Në amendamentin 9, që i referohet ndryshimeve në nenin 23 i cili bëhet neni 22, në paragrafin 4, fjalët “*çdo vit RTK-së i ndahet 0.8% e të hyrave nga Buxheti i Kosovës*”, zëvendësohen me fjalët “**çdo vit RTK-së i ndahet 0.7% e të hyrave nga Buxheti i Kosovës**”

4. Amendamenti i propozuara nga Grupi parlamentar 6+, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Raportit më Amendamente për projektligjin nr. 04/L-98 për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror

Kryetarja, njoftoi se përkundër implikimeve buxhetore që kanë përmbajtur dispozitat e projektligjit, komisionit funksional me amendamentet i ka hequr implikimet buxhetore. Megjithatë pas analizës që iu është bërë projektligjit kemi vërejtur se duhet të intervenojmë dhe të bëjmë propozime që të fshihet neni 21 i projektligjit që flet për mundësinë e shfrytëzimit të taksave nga Agjencia, pasi që kjo është në kundërshtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Gjithashtu të propozojmë të fshihet amendamenti 19 i komisionit funksional, pasi i referohet riformulimeve të nenit 21. Si dhe të propozojmë një amendament që në amendamentin 8, paragrafi 9, të komisionit funksional të shtohen fjalët “sipas mundësive buxhetore të lejuara me Ligjin vjetor të buxhetit”, që nënkupton se Agjencia do të mund të angazhojë personel profesional dhe administrativ sipas mundësive buxhetore të lejuara me buxhetin vjetor.

Pas propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 04/L-98 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e navigacionit ajror, nuk përmban implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të nenit 21.

Amendamenti 1

Neni 21 i projektligjit, hiqet. (Në vazhdim të bëhet rirenditja e neneve)

Arsyetim

Shfrytëzimi i mjeteve nga taksat që inkasojnë agjencionet dhe institucionet shtetërore, është i rregulluar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për Projektligjin nr. 04/L-98 për Themelimin e Agjencisë për Shërbimet e navigacionit ajror, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 8 dhe amendamentit 19.
3. Komisioni propozon ndryshimet si në vijim:

Amendamenti 2

Në amendamentin 8 të komisionit funksional që i referohet ndryshimeve në nenin 5 të projektligji, në paragrafin 9, pas fjalës “ *të nevojshme*”, të shtohen fjalët “**sipas mundësive buxhetore të lejuara me Ligjin vjetor të Buxhetit**”.

Arsyetim

AShNA, do të mund të angazhojë personel profesional dhe administrativ sipas mundësive buxhetore të lejuara me buxhetin vjetor.

Amendamenti 3

Amendamenti 19 i komisionit funksional, fshihet.

Arsyetim

Amendamenti 19 duhet të fshihet, si pasojë e amendamentit të propozuar Komisioni për Buxhet dhe Financa për fshirjen e nenit 21 të projektligjit, pasi që amendamenti 19 i referohet ndryshimeve të këtij neni.

5. Të ndryshme.

Kryetarja, njoftoi e raporti me amendamente për Projektligjin për Fondet Pensionale në Kosovë, ka kaluar procedurat e shqyrtimit në komisionet tjera të përhershme , të cilat nuk kanë vërejtje dhe Raporti final me amendamente, do të procedohet sot për miratim në seancë plenare.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj